



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.94

26 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.400, datë 11.7.2007	Për ndarjen e Fakultetit të Bujqësisë dhe krijimin e tri fakulteteve, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.....	2683
Vendim i KM nr.401, datë 11.7.2007	Për miratimin e kërkesave rregullative të Eurokontrollit për sigurinë në Aviacionin Civil Shqiptar.....	2683
Vendim i KM nr.403, datë 11.7.2007	Për dhënien e emrit “Gani Strazimiri” Institutit të Monumenteve të Kulturës	2684
Vendim i KM nr.408, datë 11.7.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Suha 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	2684
Vendim i KM nr.410, datë 11.7.2007	Për transferimin e paketës së aksioneve të AMC sh.a., që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish- pronarët e truallit dhe te punonjësit e kësaj shoqërie.....	2685
Vendim i KM nr.411, datë 11.7.2007	Për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme të shtetit të objektit “Vila kodër dhe territori përreth”, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.....	2685
Vendim i KM nr.412, datë 11.7.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës “Godinë 2-katëshe”, nga Agjencia Telegrafike Shqiptare te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.444, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Telegrafike Shqiptare”	2689

Vendim i KM nr.413, datë 11.7.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit).	2692
Vendim i KM nr.414, datë 11.7.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës.....	2692
Vendim i KM nr.415, datë 11.7.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Libohovë të qarkut të Gjirokastrës.....	2693
Vendim i KM nr.416, datë 11.7.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit.....	2694
Vendim i KM nr.417, datë 11.7.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kutë të qarkut të Fierit.....	2695
Vendim i KM nr.418, datë 11.7.2007	Për krijimin e Institutit të Kurrikulave e të Trajnimit dhe shkrirjen e Institutit të Kurrikulave e të Standardeve dhe të Qendrës së Trajnimit e Kualifikimit për Arsimin.....	2695
Vendim i ERE nr.41, datë 13.7.2007	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje.....	2697
Vendim i ERE nr.42, datë 13.7.2007	Për fillimin e procedurës për ndryshimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare dhe jofamiljare.....	2697
	Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës dytësore Tiranë-Vorë (krahu i majtë).....	2698
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Enkeleid Fadil Gjuzit..	2703

VENDIM
Nr.400, datë 11.7.2007

**PËR NDARJEN E FAKULTETIT TË BUJQËSISË DHE KRIJIMIN E TRI FAKULTETEVE,
NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndarjen e Fakultetit të Bujqësisë dhe krijimin e tri fakulteteve të reja në Universitetin Bujqësor të Tiranës, me këto emërtime:

- a) Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit;
- b) Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit;
- c) Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi, në vitin akademik 2007-2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.401, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE RREGULLATIVE TË EUROKONTROLLIT PËR
SIGURINË NË AVIACIONIN CIVIL SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, si dhe të nenit 2.1, pika IV, e protokollit 1, të ligjit nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, në Kosovë “Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian””, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kërkesave rregullative të Eurokontrollit, për sigurinë në Aviacionin Civil Shqiptar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.403, datë 11.7.2007

PËR DHËNIEN E EMRIT “GANI STRAZIMIRI” INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Instituti të Monumenteve të Kulturës t’i jepet emri “Gani Strazimiri”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.408, datë 11.7.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SUHA 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Suha 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Albaenergiaplus” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.410, datë 11.7.2007

PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË AMC SHA, QË KA MBETUR PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË, TEK ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 2, 3, pika 3, e 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communications” (AMC)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e aksioneve të AMC sh.a., që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish-pronarët e truallit dhe të punonjësit e kësaj shoqërie të transferohet, nëpërmjet ankandit, me asistencën e shoqërisë konsulente ndërkombëtare.

2. Shpenzimet për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit dhe për shërbimet e tij, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për transferimin e paketës të përballohen nga pjesa e dividendit të ortakut shtetëror në AMC sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.411, datë 11.7.2007

**PËR HEQJEN NGA INVENTARI I PRONAVE TË PALUAJTSHME TË SHETIT TË
OBJEKTIT “VILA KODËR DHE TERRITORI PËRRETH”, NË ADMINISTRIM TË
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, e 8, pika 3, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme të shtetit, të objektit “Vila kodër dhe territori përreth”, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, për zbatimin e vendimit nr.66, datë 6.4.2006, të komisionit vendor të kthimit dhe kompensimit të pronave, të qarkut Durrës.

2. Pika 1 e kreut II “Për rrethin e Durrësit” e listës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.34, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

REGJISTRIMI TE
VE TE PALUEJTESHME

DURRES

REGJISTRUESI I RRETHIT

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 85/2 NR. PASURISE 28/160 VOL. 3 FO/93 SIP= 508/96 m²
INDEKSI I HARTES 1K-21F-2.2 SHKALLA 1:1000 7 muller pa detyr
51 m² - 1025/48

ADRESA E PASURISE: Rrethi DURRES Q/ R. DURRES
Rr/L FINIA / 11 P/G — Sh — K — Ap —

B. KUFIZIMET

V. PASURIA Nr. —


L. PASURIA Nr. —

J. PASURIA Nr. —

P. PASURIA Nr. —

C. PRONARI

Data: 03 / 02 / 2006 Ora: 11⁰⁰





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMITETI SHTETETOR I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE
KOMISION VENDOR I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE
QARKU _____

(adresa)

PLAN VENDOSJA E PRONES

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE:

ZONA KADASTRALE Nr 8512 Emri _____ INDEKSI I HARTES DR-Jk-2,3 SHKALLA 1:1000

ADRESA E PASURISE: Rrethi Durres QJ Durres Rr/ Rinia/21 PIG _____


B. PERSHKRIMI I PASURISE: LLOJI I PASURISE Truall + Ndertese

SIPERFAQJA E NJOHUR 5081,96 m². SIPERFAQJA E KTHYER 5081,96 m². SIPERFAQJA E KOMPENSUAR _____ m²


C. PROVARI/BASHKEPRONARET: Familja Mbreterore (Leka ZOGU)

SHENJA KONVENCIONALE:



Prona e pretenduar
Vije kutizuese e pandërprerë



Pronë e njohur
(me viza horizontale)



Pronë e kthyer/Kompensuar Fizikisht
(me viza në formë rrjeti)



PUNOI:

Ing. Artan SEMINI

Data: 24 / 05 / 2006

KVKKP:

1. Artan SEMINI
2. Arben TARAKU
3. Kristaq SHUKA

Kryetar

Anëtar

Anëtar



ENDORE E REGJISTRIMIT
ASURIVE SI PALLATISIME

DURRES

A. IDENTIFIKIMI PASURISE

ZONA KADASTRALE 2512 NR PASURISE 28/176
INDIKUIM HARTES 88-28-2-2 CHIKALLI 11/10/2006
ADRESA E PASURISE Rrethi Durres Q/ DURRES
Rr. ELIA ALP/G Sh. K Ap. 1

REGJISTRUESI RRETHI

B. KUFIZIME

C. PRONARI

V. PASURIA Nr 28/176

L. PASURIA Nr 28/176


J. PASURIA Nr 28/176

P. PASURIA Nr 28/176

LEKA I ZOGU

D. Data 09 / 10 / 2006 Ora 16

EDMOND HOXHA



VENDIM
Nr.412, datë 11.7.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS “GODINË 2-KATËSHE”, NGA AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE TE MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.444, DATË 16.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Godinë 2-katëshe” nga Agjencia Telegrafike Shqiptare te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për dhënien në përdorim Unionit (Bashkimit) të Dhomave të Tregtisë, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.


2. Për pronën “Ndërtesa ekzistuese e ATSH-së”, me numër rendor 1, në formularin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.444, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Telegrafike Shqiptare”, shfuqizohet pjesa “Sipërfaqe truall dhe sipërfaqe ndërtesë”, që, përkatësisht, i përket objektit “Godinë 2-katëshe”, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, drejtori i Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCE Projekt VKM
HTR Godina e ATSH + godina 2 kt per kalim ne dministim te METE



TR: P-13



VENDIM
Nr.413, datë 11.7.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit). Lista përbëhet nga 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, drejtori i Përgjithshëm i Rezervave të Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.414, datë 11.7.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Lezhë, të qarkut të Lezhës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Lista me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 291 (dyqind e nëntëdhjetë e një).
4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6,107-113, 115-131, 133-137, 141, 142, 266, 289, 290	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
24-30, 33-37, 40	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
11-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
42, 45, 46	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
143-168	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
72-98, 169-208, 211-234, 251-258, 286, 288	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte sip. të gjelbëruara) dhe shërbime publike	Në pronësi
99-102	Varrezat publike	Në pronësi
69-71	Troje dhe hapësira	Në përdorim
103-105	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
5, 260, 2, 261, 3-261, 6, 261, 9-261, 16, 262-262, 8, 262, 10-262, 12, 262, 15, 262, 16, 264, 265, 287, 291	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi

VENDIM
Nr.415, datë 11.7.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LIBOHOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Libohovë të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 32 (tridhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Libohovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.416, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË ELBASAN TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 947 (nëntëqind e dyzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Elbasan

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5, 118, 451-452, 844-853	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
21-23, 26	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative	Në pronësi
28, 29	Prona që përdoren nga partitë politike	Në pronësi
51-112	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
405-407, 409-420	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
238-247, 265, 266, 267, 268, 269, 456, 842, 843	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
248-259, 263, 264, 271	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
272, 841	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
280-399, 854-947	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
400-402, 490-617, 641-656	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
486	Varreza publike	Në pronësi
618-640	Troje dhe hapësira	Në përdorim

VENDIM
Nr.417, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË KOMUNËN KUTË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Kutë të qarkut të Fierit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 30 (tridhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.418, datë 11.7.2007

**PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KURRIKULAVE E TË TRAJNIMIT DHE SHKRIRJEN
E INSTITUTIT TË KURRIKULAVE E TË STANDARDEVE DHE TË QENDRËS SË
TRAJNIMIT E KUALIFIKIMIT PËR ARSIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT) si institucion në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe shkrirjen e Institutit të Kurrikulave dhe Standardeve (IKS) e të Qendrës së Trajnimit dhe të Kualifikimit për Arsimin (QTKA).

2. Misioni i IKT-së është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar shqiptar.

3. IKT-ja ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues për politikat arsimore.

4. IKT-ja ka për detyrë:

a) Të kryejë studime e shërbime në fushën e arsimit parauniversitar;
b) Të kontribuojë në hartimin e politikave arsimore në fushën e arsimit parauniversitar dhe në hartimin e strategjive për zbatimin e këtyre politikave;

c) Të hartojë standardet e programet lëndore, si dhe përbërës të tjerë të kurrikulave, mbështetur në konceptet e praktikat e reja pedagogjike;

ç) Të ndjekë zhvillimin e teknologjive arsimore dhe të ndërmarrë nisma, si dhe të mbështesë zbatimin dhe përmirësimin e tyre;

d) Të ndjekë, në vazhdimësi, nevojat profesionale të mësuesve e të drejtuesve të shkollave;

dh) Të hartojë dhe realizojë programe, për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit arsimor.

5. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton statutin dhe rregulloren e funksionimit të IKT-së.

6. Drejtuesi i IKT-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IKT-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Numri i punonjësve të IKT-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

10. IKT-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

11. Vendimet nr.654, datë 25.9.2003 “Për krijimin e Institutit të Kurrikulave e të Standardeve (IKS) dhe për shkrirjen e Institutit të Studimeve Pedagogjike” dhe nr.655, datë 25.9.2003 “Për krijimin e Qendrës së Trajnimit dhe të Kualifikimit për Arsimin” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.41, datë 13.07.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E SAKTË TË VLERËS SË GJOBËS DHE TË DËMIT TË SHKAKTUAR ENTIT SHPËRNDARËS PËRKATËS, SIPAS LLOJIT TË SHKELJES, MADHËSISË SË FUQISË SË INSTALUAR NË OBJEKT DHE KOHËS SË VËRTETUAR ME SHKELJE

Në mbështetje të nenit 9, nenit 46/1, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa “a”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2007, pasi shqyrtoi draftin e dërguar nga shoqëria KESH sh.a. për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje,

VENDOSI:

1. Miratimin e fillimit të procedurave për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje.

2. Ngarkohet grupi i punës për shqyrtimin e procedurave për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.42, datë 13.7.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT
ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE DHE
JOFAMILJARE**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, dhe nenit 44, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 11 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionereve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për ndryshimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare dhe jofamiljare.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për hartimin e ndryshimeve të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare dhe jofamiljare, të miratuara me vendimin nr.40 dhe 41 të datës 31.8.2005 të Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës dytësore Tiranë-Vorë (krahu i majtë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët, që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 316 559 592 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

**Lista e pronareve ,pronat e te cileve shpronesohen nga qe preken nga
ndertimi i rrugeve paralele Tirane - Vore (Krahu i Maite).**

Nr.	Emri	Pronari		Zona	Nr.	Pasurise	Lloji	Cmimi /m2	Vlera / leke	Objekt	Vlera e objektit	Vlera Totale	Shenime
1	Kaplan	Qermal	Mance	2679	124/8	are	340	4281	1455540			1455540	Plotësim dokumentacioni
2	Shkelqim	Fatbardh	Almadhi	2679	124/7	are	204	4281	873324			873324	Plotësim dokumentacioni
3	I paidentifikuar			2679	124/16	are	102	4281	436662			436662	Plotësim dokumentacioni
4	Shkelqim	Fatbardh	Almadhi	2679	123/7,10,11,13	are	1623	4281	6948063			6948063	Plotësim dokumentacioni
5	I paidentifikuar			2679	122/18	are	1411	4281	6040491			6040491	Plotësim dokumentacioni
6	I paidentifikuar			2679	122/4	are	408	4281	1746648			1746648	Plotësim dokumentacioni
7	Shaqir	Xhemal	Alla	2679	121/10	are	354	4281	1515474			1515474	Plotësim dokumentacioni
8	Shaqir	Xhemal	Alla	2679	121/11	are	170	4281	727770			727770	Plotësim dokumentacioni
9	Muharrem	Xhemal	Alla	2679	120/1	are	1700	4281	7277700			7277700	Plotësim dokumentacioni
10	Lulzim	Xhemal	Alla	2679	119/10	are	442	4281	1892202			1892202	Plotësim dokumentacioni
11	Besnik	Vasil	Zhapa	2679	119/9	are	510	4281	2183310			2183310	Plotësim dokumentacioni
12	Ramiz		Abili	2679	119/8	are	535	4281	2290335			2290335	Plotësim dokumentacioni
13	I paidentifikuar			2679	119	are	2040	4281	8733240			8733240	Plotësim dokumentacioni
14	Bashkepronesi Nr dok.2273			2679	119/5	are	1700	4281	7277700			7277700	Plotësim dokumentacioni
15	Pellumb	Sedar	Almadhi	2679	50/1	are	1632	4281	6986592			6986592	Plotësim dokumentacioni
16	Skender	Islam	Gazheli	2679	47/61	are	2550	4281	10916550			10916550	Plotësim dokumentacioni
17	Bedri	Xhevdet	Rryta	2679	41/2/3	are	1385	4281	5929185			5929185	Plotësim dokumentacioni
18	I paidentifikuar			2679	41/2/2	are	835	4281	3574635			3574635	Plotësim dokumentacioni
19	I paidentifikuar			2679	41/2/1	are	1105	4281	4730505			4730505	Plotësim dokumentacioni
20	Fatos	Hasan	Miraci	2679	41/1/5	are	680	4281	2911080			2911080	Plotësim dokumentacioni
21	Ilirjan	Dhimiter	Koroveshi	2679	41/1/4	are	629	4281	2692749			2692749	Plotësim dokumentacioni
22	Ivan	Petra	Ilia	2679	41/61	are	303	4281	1297143			1297143	Plotësim dokumentacioni
23	Kujtim	Ferhat	Elez	2679	41/63	are	1037	4281	4439397			4439397	Plotësim dokumentacioni
24	Bashkim	Elez	Ferhat	2679	41/13/1	are	330	4281	1412730			1412730	Plotësim dokumentacioni

25	Ilir	Kadri	Kutri	2679	41/14/1	are	330	4281	1412730	1412730	Plotësim dokumentacioni
26	Ismail	Osman	Kosova	2679	31/12	are	1241	4281	5312721	5312721	Plotësim dokumentacioni
27	Artur	Cela	Cela	2679	28/40	are	632	4281	2705592	2705592	Plotësim dokumentacioni
28	Hasan	Osman	Kosova	2679	28/18	are	300	4281	1284300	1284300	Plotësim dokumentacioni
29	Pa Identifikuar			2679	28/17	are	214	4281	916134	916134	Plotësim dokumentacioni
30	Musli	Qerim	Ponari	2679	28/17	are	332	4281	1421292	1421292	Plotësim dokumentacioni
31	Harri	Folo	Lena	2679	28/45	are	1275	4281	5458275	5458275	Plotësim dokumentacioni
32	Foti	Qemal	Rustemi								Plotësim dokumentacioni
33	Ylli	Qemal	Rustemi	2679	28/46	are	340	4281	1455540	1455540	Plotësim dokumentacioni
34	Arben	Todi	Peto								Plotësim dokumentacioni
35	Xhuli	Qemal	Rustemi	2679	28/45	are	476	4281	2037756	2037756	Plotësim dokumentacioni
36	Kosia	Sheme	Cora								Plotësim dokumentacioni
37	Vilson	Ilia	Cora	2679	28/14	are	595	4281	2547195	2547195	Plotësim dokumentacioni
38	'Galanxy Motors Palace " sh.p.k			2679	19/23, 19/24	are	884	4281	3784404	3784404	Plotësim dokumentacioni
39	Besnik	Muhamet	Stojku								Plotësim dokumentacioni
40	Rexhep	Muhamet	Stojku	2679	19/27	are	850	4281	3638850	3638850	Plotësim dokumentacioni
41	" Renault " sh.p.k			2697	19/2	are	935	4281	4002735	4002735	Plotësim dokumentacioni
42	'Kadiu " sh.p.k			2679	28/43	are	714	4281	3056634	3056634	Plotësim dokumentacioni
43	'ETI Bozgo " sh.p.k			2679	19/25	are	586	4281	2508666	2508666	Plotësim dokumentacioni
44	Pa Identifikuar			2679	13/69	are	688	4281	2945328	2945328	Plotësim dokumentacioni
45	Bledar	Kasem	Cerbashi	2679							Plotësim dokumentacioni
46	Neritan	Abaz	Dajaka	2679	13/42;13/45;13/47	are	935	4281	4002735	4002735	Plotësim dokumentacioni
47	Pa Identifikuar			2679	13	are	51	4281	218331	218331	Plotësim dokumentacioni
48	Njazi		Lacka	2679	13	are	170	4281	727770	727770	Plotësim dokumentacioni
49	Bledar	Kasem	Cerbashi								Plotësim dokumentacioni
50	Neritan	Abaz	Dajaka	2679	13/49, 13/74	are	680	4281	2911080	2911080	Plotësim dokumentacioni
51	Qemal	Qazim	Lacka	2679	13/40	are	95	4281	406695	406695	Plotësim dokumentacioni
52	Nuri	Qazim	Lacka	2679	13/38	are	131	4281	560811	560811	Plotësim dokumentacioni
53	Bashkim	Qazim	Lacka	2679	13/42	are	131	4281	560811	560811	Plotësim dokumentacioni
54	Pa Identifikuar			2679	13/78	are	442	4281	1892202	1892202	Plotësim dokumentacioni
55	Edmond	Anastas	Ziso	2679	13/74	are	2380	4281	10188780	10188780	Plotësim dokumentacioni
56	Pa Identifikuar			2679	13/20	are	850	4281	3638850	3638850	Plotësim dokumentacioni
57	Arapke	Ferik	Murataj	2679	11/44	trull	646	14602	9432892	9432892	Plotësim dokumentacioni
58	Arapke	Ferik	Murataj	2679	11/45	trull	646	14602	9432892	9432892	Plotësim dokumentacioni
59	Shoqeria" E. H. e "sh.p.k			2679	11/35	trull	1113	14602	16252026	16252026	Plotësim dokumentacioni
60	Drita	Merko	Mehilli	2679	11/41	are	969	4281	4148289	4148289	Plotësim dokumentacioni
61	Riko	Niko	Plika	2679	11/49	are	918	4281	3929958	3929958	Plotësim dokumentacioni
62	Erika	Albania	Ceramikë	2679	11/47	trull	1119	14602	16339638	16339638	Plotësim dokumentacioni
63	Erika	Albania	Ceramikë	2679	11/37	trull	238	14602	3475276	3475276	Plotësim dokumentacioni
64	Pa Identifikuar			2679	11	are	773	4281	3309213	3309213	Plotësim dokumentacioni
65	Pa Identifikuar			2679	11	are	289	4281	1237209	1237209	Plotësim dokumentacioni
66	Pa Identifikuar			3965	287	are	80	3000	240000	240000	Plotësim dokumentacioni

60	Pa identifikuar			3885	287	are	204	3000	612000		612000	Plotësim dokumentacioni
61	Ylli	Sali	Avdia	3885	287/17	are	170	3000	510000		510000	Plotësim dokumentacioni
62	Pa identifikuar			3885	287/15	are	94	3000	282000		282000	Plotësim dokumentacioni
63	Ramazan	Maksut	Peza	3885	287/14	are	94	3000	282000		282000	Plotësim dokumentacioni
64	Islam		Peza	3885	287/13	are	94	3000	282000		282000	Plotësim dokumentacioni
65	Petrit	Zeni	Xheli	2119	210/10	are	374	2562	958188		958188	Plotësim dokumentacioni
66	Dionis	Ahmet	Tejga	2119	210/31	are	561	2562	1437282		1437282	Plotësim dokumentacioni
67	Evjini	Perikli	Xhoanli	2119	210/1; 210/2	are	938	2562	2403156		2403156	Plotësim dokumentacioni
68	Hamit		Peza	2119	211	are	408	2562	1045296		1045296	Plotësim dokumentacioni
69	Xhelal		Peza	2119	211	are	425	2562	1088850		1088850	Plotësim dokumentacioni
70	'Fish Factory " sh.p.k			2119	211	are	102	2562	261324		261324	Plotësim dokumentacioni
71	Pa identifikuar			2119	211/1/23	are	90	2562	230580		230580	Plotësim dokumentacioni
72	Agron	Qazim	Shlepani	2119	211/1/22	are	90	2562	230580		230580	Plotësim dokumentacioni
73	Lulzim	Qazim	Shlepani	2119	211/1/21	are	56	2562	143472		143472	Plotësim dokumentacioni
74	Astrit	Qazim	Shlepani	2119	211/1/20	are	128	2562	327936		327936	Plotësim dokumentacioni
75	Xhafer	Ali	Geci	2119	211/2/1	are	466	2562	1193892		1193892	Plotësim dokumentacioni
76	Rame	Jakup	Xhidia	2119	211	are	466	2562	1193892		1193892	Plotësim dokumentacioni
77	Rus			2119	211	are	466	2562	1193892		1193892	Plotësim dokumentacioni
78	Pa identifikuar			2119	211/31	are	726	2562	1860012		1860012	Plotësim dokumentacioni
79	Liri	Mahmut	Haroku	2119	212/18	are	1530	2562	3919860		3919860	Plotësim dokumentacioni
80	Bledar	Mahmut	Haroku	2119	212/23	are	544	2562	1393728		1393728	Plotësim dokumentacioni
81	Leonard	Mahmut	Haroku	2119	212/28	are	473	2562	1211826		1211826	Plotësim dokumentacioni
82	Vait	Islam	Luzi	2119	212/27	are	561	2562	1437282		1437282	Plotësim dokumentacioni
83	Benet		Skenderaj	2119	212/29	are	1165	2562	2984730		2984730	Plotësim dokumentacioni
84	Pa identifikuar			2119	212/31	are	553	2562	1416786		1416786	Plotësim dokumentacioni
85	' Neranxy " sh.p.k.			2119	212/1/5	are	442	2562	1132404		1132404	Plotësim dokumentacioni
86	' Piro " sh.p.k.			2119	214/17	are	969	2562	2482578		2482578	Plotësim dokumentacioni
87	' Alba Cement Ital " sh.p.k			2119	214/16	are	255	2562	653310		653310	Plotësim dokumentacioni
88	Bujar	Skender	Gazheli	2119	214/15	are	357	2562	914634		914634	Plotësim dokumentacioni
89	Miranda	Mustafa	Sali	2119	214/2/6	are	802	2562	1729350		1729350	Plotësim dokumentacioni
90	Miranda	Mustafa	Sali	2119	214/8	are	765	2562	1959930		1959930	Plotësim dokumentacioni
91	Epton	Niko	Gjipali	2119	214/6	are	1105	2562	2831010		2831010	Plotësim dokumentacioni
92	Hysen	Sabaudin	Kasemaj	2119	214/5	are	619	2562	1585878		1585878	Plotësim dokumentacioni
93	Pellumb	Isuf	Pula	2119	214/4	are	493	2562	1263066		1263066	Plotësim dokumentacioni
94	Pa identifikuar			2119	214/3	are	675	2562	2054724		2054724	Plotësim dokumentacioni
95	Pa identifikuar			2119	214/8	are	765	2562	1959930		1959930	Plotësim dokumentacioni
96	Pa identifikuar			2119	214/6	are	1105	2562	2831010		2831010	Plotësim dokumentacioni
97	Vildan	Mustafa	Docu	2119	214/5	are	619	2562	1585878		1585878	Plotësim dokumentacioni
98	Kasem		Lieshi	2119	214/4	are	493	2562	1263066		1263066	Plotësim dokumentacioni
99	Pa identifikuar			2119	214/3	are	675	2562	2054724		2054724	Plotësim dokumentacioni
100	Edmond	Shahin	Bulica	2105	1186/13	are	527	2538	1337526		1337526	Plotësim dokumentacioni
101	Saimir	Gjyrezi		2105	1186/10	are	1836	2538	4659768		4659768	Plotësim dokumentacioni
102	Rasim	Halim	Lieshi	2105	1186/8	are	680	2538	1725940		1725940	Plotësim dokumentacioni

Rregjet parase (vezhu / majte)

95	Kasem	Lleshi	2105	1186/9	are	340	2538	862920	862920	Plotesim dokumentacioni
96	Pa identifikuar		2105	287	are	4080	2538	10355040	10355040	Plotesim dokumentacioni
SHUMA						70469		296855403	316559592	

KËRKESË

Unë, Hane Gjuzi, e bija e Xhemalit dhe e Xhemiles, lindur dhe banuar në Durrës, kërkoj shpalljen të vdekur të djalit tim, Enkeleid Fadil Gjuzit, zhdukur në vitin 1994.

KËRKUESJA
Hane Gjuzi

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 24.7.2007
Doli nga shtypi më 26.7.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë